



VENDIM

Nr. 108, datë 29.06.2016

MBI

**KËRKESËN E SHOQATËS SHQIPTARE TË ENERGJISË SË
RINOVUESHME PËR RISHIKIMIN/PEZULLIMIN E VENDIMIT
TE BORDIT TE ERE-s NR 77 DATË 07.06.2016 “PËR FILLIMIN E
PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË TREGUT
SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE”.**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenit 16, pika 4 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.06.2016 të Bordit të ERE, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.06.2016, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, mbi kerkesen e Shoqatës Shqiptare të Energjisë së Rinovueshme AREA, për rishikimin/pezullimin e vendimit nr. 77, datë 07.06.2016, të Bordit të ERE-s,

Konstatoi se:

- Në nenin 108 pika 3 të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” parashikohet se “Ngarkohet ERE që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.... të miratojë me propozimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike, rregullat e tregut të energjisë elektrike.”
- Nuk është paraqitur asnjë prove e re, për të mbështetur kerkesen për rishikim/pezullimin e procedurave të miratimit të “Rregullave të Tregut.”
- Shoqata AREA nuk përfaqëson palë interesi, të legjitimuar për të kërkuar rishikimin e një vendimi të Bordit të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të refuzojë kërkesën e Shoqatës Shqiptare të Energjisë së Rinovueshme AREA, për rishikimin/pezullimin e vendimit nr. 77, datë 07.06.2016, të Bordit të ERE-s, “Për fillimin e procedurave për miratimin e rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike.”

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë AREA-n , për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.